

VENDIM
Nr.155, datë 11.2.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË NDËRTIMIT TË PORTIT TË JAHTVE NË KEPIN E RODONIT,
GJIRI I LALZIT, DURRËS, DHE PËR MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN
PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të ndërtimit të portit të jahteve në Kepin e Rodonit, Gjiri i Lalzit, Durrës, është Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

2. Koncesioni do të jetë i formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim në pronësi të shtetit).

3. Miratimin e bonusit prej 8.3 përqindësh të pikëve, për rezultatin, teknik, financiar dhe mjedisor, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Ener Alb-Projects” sh.p.k.

4. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha